



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:200126

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05505698

Ac.nr.2268/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve: të paditësve H.S., F.S. dhe G.S., të gjithë nga fshati P....., Komuna e Gj....., të cilët i përfaqëson “Avokatura Istrefi” nga P..... kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” në P....., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.808/19, i datës 23.10.2020, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës: Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” në P....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.808/19, i datës 23.10.2020, në pikën I të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë, sa i përket dëmit material, për shpenzimet e varrimit dhe për ngritjen e përmendores, në pikën I të dispozitivit për kamatën dhe në pikën III të dispozitivit në pjesën e kërkesës për shpenzimet e procedurës, VËRTETOHET.

II. PRANOHET pjesërisht ankesa e të paditurës: Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, me seli në P....., NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm C.nr.808/19, i datës 23.10.20120, në pikën I, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë, sa i përket dëmit jo material, për dhimbjet shpirtërore për paditësit: H.S., F.S. dhe G.S., të gjithë nga fshati P....., Komuna e Gj.....it dhe gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, me seli në P....., që paditësve në emër të kompensimit të dëmit jo material, për dhimbjet shpirtërore për shkak të vdekjes së djalit respektivisht valluat G.S1, si pasojë e aksidentit të komunikacionit rrugor të datës 04.07.2019, ti paguaj shumën e specifikuar dhe atë:

- Paditësit: H.S.: në emër të kompensimit të dëmit jo material, për dhimbjet shpirtërore për shkak të vdekjes së djalit shumën prej 15,000.00 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përtej shumës së gjykuar, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

- Paditëses: F.S.: në emër të kompensimit të dëmit jo material, për dhimbjet shpirtërore për shkak të vdekjes së djalit shumën prej 15,000.00 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përtej shumës së gjykuar, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

- Paditëses: G.S.: në emër të kompensimit të dëmit jo material, për dhimbjet shpirtërore për shkak të vdekjes së vëllait shumën prej 8,000.00 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përtej shumës së gjykuar, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

III. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën II, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësve.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.808/19, i datës 23.10.2020 ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve H.S., F.S. dhe G.S., të gjithë nga fshati P....., Komuna e Gj.....it, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në P..... dhe **DETYROHET** e paditura që paditësve si në vijim ti paguaj edhe atë:

a). **Paditësit H.S.** në emër të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore, shumën e përgjithshme prej 20.000,00€ (njëzet mijë euro),

b). **Paditëses F.S.** në emër të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore, shumën e përgjithshme prej 25.000,00€ (njëzet e pesë mijë euro),

c). **Paditëses G.S.** në emër të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore, shumën e përgjithshme prej 11.000,00€ (njëmbëdhjetë mijë euro), kurse

d). Në emër të dëmit material e paditura ti paguaj, paditësit H.S. shumën prej 1.800,00€ (njëmijë e tetëqind euro) për shpenzimet e varrimit dhe ngritjes së përmendores.

Të gjitha shumat e aprovuara si më lartë, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke llogaritur nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET SI E PA BAZUAR pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditësve H.S., F.S. dhe G.S., sa i përket dëmit material përtej shumës së gjykuar edhe atë shuma prej 1,200.00€, ku kanë kërkuar që e paditura Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në P....., që në emër të shpenzimeve të varrimit dhe ngritjen e përmendores t’i paguaj shumën prej 3,000.00€.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në P..... që paditësve H.S., F.S. dhe G.S., t’ia paguaj shpenzimet e kësaj procedure, në shumën e përgjithshme prej 2,017.16€, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e Apelit ankesën e të paditurës ta aprovoj si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar të shkallës së parë ta prish dhe çështjen t’ia kthej në rigjykim gjykatës së shkallës së parë ose ta ndryshoj aktgjykimin në shumën e ofruar nga e paditura.

Ankesa e të paditurës ju është dorëzuar të autorizuarit së paditësve, i njëjta nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit me datë 11.09.2019, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi, të precizuar si në parashtrësën e datës 06.07.2020 kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” në P....., me të cilën ka kërkuar që të: Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e

paditësve H.S., F.S. dhe G.S., të gjithë nga fshati P....., Komuna e Gj.....it dhe Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”- P....., që paditësve t’ia kompensoj dëmin në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të humbjes së më të dashurit të tyre, për shkak të lëndimit të marr në aksidentin e komunikacionit të datës 04.07.2019 i cili për pasojë ka pasur vdekjen e tani të ndjerit G.S1 edhe atë: për përjetimin e dhimbjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së djalit, paditës H.S. babait të të ndejrit shumen prej 20,000.00 €, paditëses F.S. nenes së të ndejrit shumen 25,000.00 €, dhe paditëses G.S. motres të të ndjerit shumen prej 11,000.00 €, si dhe paditësit H.S. demin material për shpenzimet e organizimit të ceremonisë së varrimit të të ndjerit G.S1 në shumë prej 1,500.00 €, për rregullimin e varrit - ngritjen e lapidarit në shumë prej 1,500.00 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8 % sipas nenit 382 paragraf 2 të LMD-së dhe atë nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, II. Detyrohet e paditura që paditësve shumat e cekura në pikat e këtij dispozitivit si dhe shpenzimet e procedurës t’ia paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit me kërcënim të përmbarimit forcërisht.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresat tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.808/19, i datës 23.10.2020, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: Për palët ndërgjyqësve nuk kanë qenë kontestuese faktet se me dt.04.07.2019 ka ndodhur aksident trafiku, ku ka humbur jetën qytetari G.S1, i cili ka qenë fëmijë – djalë i vetëm i paditësve H. dhe F.S. dhe vëlla i paditëses G.S.. Përgjegjës për këtë aksident ka qenë qytetari K.Z.dhe vetura e tij ka qenë i siguruar te e paditura, por sido që të jetë gjykata në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes duke analizuar secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku nga provat tjera ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Nga aktgjykimi PKR.nr.110/19, e dt.26.12.2019, gjykata vërtetoi faktin se shkaktori i aksidentit K.Z.është shpallur fajtor dhe i njëjti është gjykuar nga kjo gjykatë.Nga deklaratat për bashkësi familjare gjykata vërtetoi faktin se që të tre paditësit kanë jetuar në bashkësi familjare të vazhdueshme me tani të ndjerin G.S1.

Tutje gjykata e shkallës së parë ka shtuar se duke vërtetuar gjendjen faktike të shpjeguar si më lartë, përkatësisht duke vërtetuar se shakatar i aksidentit ka qeni i siguruari i të paditurës dhe në këtë aksident ka humbur jetën G.S1, i cili ka qenë djalë i vetëm i paditësve H. dhe F.S. dhe vëlla i vetëm paditëses G.S., ku nga kjo humbe përveç dëmit material, paditësit ka pësuar edhe dëm jo material, prandaj bazuar në këtë gjendje në njërën anë, kurse në anën tjetër, duke zbatuar dispozitat ligjore 136.1, 137, 140, 179 dhe 183 pika 1 dhe 2 dhe 184 pika 1 dhe 2 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve lidhur me nenin 9 dhe 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, prandaj vendosi si në pikën I, nën-pikat a), b), dhe c) të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket lartësisë së shumave të gjykuara për dëmin jo material, edhe atë për paditësin H.S. gjykata gjykoj shumë prej 20,000.00€ (si në pikën I nën-pikën a), paditësen F.S. shumë prej 25,000.00€ (si në pikën I nën-pikën b) dhe për paditësen G.S., shumë prej 11,000.00€ (si në pikën I nën-pikën c) edhe atë duke u bazuar në nenin 323 të LPK-ës, pasi që në rastin konkret baza juridike nuk është kontestuese por vetëm lartësia e kërkesëpadisë e në pamundësi për ta përcaktuar në mënyre të saktë shumat për dëmin jo material, gjyqtari i çështjes vendosi sipas çmuarje së lirë, bazuar në praktikat gjyqësore në raste të ngjajshme dhe duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit mjekësor të psikiatrit Dr. R.H., ku i njëjti siç shpjeguam në gjendjen faktike, gjykata ka vërtetuar se paditësit me këtë humbje të djalit të tyre të vetëm, padyshim që është një humbje jashtëzakonisht e madhe pasi që tani i ndjeri G.S1 ka qenë djali i vetëm i paditësve H. dhe F.S., përkatësisht vëlla i vetëm i paditëses G.S. dhe ky qift bashkëshortor këtë fëmijë e ka pasur mbas një kohe të gjatë pas martesës, moshë e të ndjerit e cila ka qenë në moshë shumë të re (19 vjeçar). Prandaj, shumat e gjykuar për shkak të dhimbjeve shpirtërore si më lartë, është më shumë një lloj satisfaksioni moral për paditësit me që është e ditur se çfarëdo shume, përsëri nuk do të ishte e mjaftueshme e as në proporcion të drejtë me peshën e rëndë të kësaj humbje të pësuar në aksident trafiku dhe për këto arsye

kjo gjykatë mendon se shumat e gjykuara si në pikën I, nën-pikat a, b dhe c janë shuma të arsyeshme dhe sadopak do të mund të ndikonin në zbutjen e dhimbjes të paditësve. Gjykata vendosi si në pikën I, nën-pikën d), që e paditura të kompensoj dëmin material në shumë prej 1,800.00€, duke u bazuar në faktin se e paditura këtë shumë të aprovuar nuk e ka kontestuar por ka kontestuar shumën e kërkuar prej 3,600.00€, prandaj meqë nuk ka qenë kontestuese kjo shumë e aprovuar dhe nga kjo gjendje duke u bazuar në nenin 173.1 të LMD-së lidhur me nenin 9 dhe 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Gjykata, të gjitha shumat e lartshënuara i gjykoi me kamatë ligjore prej 8% duke u bazuar në nenin 382 pika 1 dhe 2 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Ne fund Gjykata ka theksuar se vendosi si në pikën II të dispozitivit që të refuzoj shumën prej 1,200.00€ në emër të shpenzimeve materiale për shpenzimet e varrimit dhe ngritjes së përkujtimores, pasi që me asnjë provë të vetme paditësit nuk kanë vërtetuar faktin se të njëjtëve shpenzimet e varrimit dhe ngritjen e përkujtimores i ka kushtuar shuma prej 3,000.00€, prandaj bazuar në nenin 322 pika 1 dhe 2 të LPK-së, vendosi që ta refuzoj shumën prej 1,200.00€, pasi që shumën prej 1,800.00€ për dëmin material e paditura nuk e ka kontestuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar gjykata ju është referuar dispozitive nga neni 136, 137, 140, 179, dhe 183 të LMD-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në nenin 452 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitive të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitivës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitive të procedurës kontestimore nga neni 182 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuara në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar fakti se aksidenti i komunikacionit rrugorë ka ndodhur me datë 04.07.2019, në ora 22:55 në rrugën e relacionit U..... - M....., me të arritur në fshatin përball varrezave të fshatit U..... Pjesëmarrës në këtë aksident ishte automjeti i tipit “Opel Vectra”, me targa 06....., të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte K.Z., nga mospërshtatja e shpejtësisë me kushtet e rrugës me ashtu që gjate kalimit në kthesë ka humbur kontrollin mbi drejtimin e automjetit duke kaluar në shiritin e majtë të rrugës ku me këtë rast me pjesën e përparme të majtë të automjetit të tij ka goditur pjesën e përparme të majtë të automjetit e udhëtareve të markës Mercedes të cilin e ka drejtuar i ndjeri G.S1 i cili si pasojë i këtij aksidenti pëson me fatalitet. Drejtuesi i automjetit i cili ka qenë i siguruar pranë të paditurës, ka përgjegjësinë ekskluzive dhe të vetme për shkaktimin e këtij aksidenti dhe tani i ndjeri G.S1, më asnjë veprim të tij, nuk ka kontribuar në shkaktimin e këtij aksidenti. Paditësit janë familjarë gjegjësisht janë prindërit dhe motra e tani të ndjerit G.S1. Dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka

vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor”, në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë dhe më qëllim që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje, fillimisht ju ka ofruar ofertë në procedurë jashtëgjyqësore, të cilën ofertë paditësit nuk e kanë pranuar.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që të paditurat të jenë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditëseve, gjënë mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi nga data 20 Dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”.

Gjykata e shkallës së parë më rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material, ngritjen e përmendores dhe shpenzimet e varrimit, për arsye se me nenin 177 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që ti kompensoj shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij”, në këtë rast paditësve ju takon e drejta në kompensimin e këtij lloji të dëmit material. Përkundër faktit se paditësit për këtë kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, faturë - kuponë fiskal, kjo gjykatë duke i nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave të Kosovës, Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë rast paditësve ju takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumën e gjykuar, pasi që edhe më vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve, të dëmtuarve për këtë kategori të dëmeve ju njohin të drejtën në kompensim, e cila shumë është në nivelin e shpenzimeve mesatare që u krijohen familjarëve me rastin e ngritjes së lapidareve.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar si në pikën II, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 195 paragrafi 1 pika e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, sepse nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për kategoritë e dëmit jo material dhe atë: për dhimbjet shpirtërore për paditësit: H.S., F.S. dhe G.S., pasi që vlerësoj se shumata e gjykuara nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërbejnë kompensimit. Në çdo rast për dëmin jo material, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarit. Në këtë rast gjykata ka pasur parasysh raportin e paditësve me tani të ndjerin duke marr për bazë rrethanën se raportet në mes të prindërve dhe fëmijëve janë shumë emocionale, të ndjeshme dhe shpirtërore dhe në këtë vështrim Gjykata e Apelit vlerëson se dhimbjet shpirtërore të paditësve për shkak të vdekjes së djalit respektivisht vëllait të vetëm të tyre, në aksident kanë qenë të larta, e duke marr parasysh edhe rrethanat familjare në Kosovë, veçanërisht rrethanën se si ka ndodhur aksidenti, për arsye se raportet në mes të prindërve dhe fëmijëve janë shume emocionale dhe humbja e një anëtari të familjes në aksident e veçanërisht duke marr për bazë moshën e të tani të

ndjerit si dhe rrethanave si ka ndodhur aksidenti, është manifestuar me dhimbje shpirtërore shumë të larta, dhe se këto dhembje janë vërtetuar edhe në bazë të mendimit të ekspertit mjekësor dhe duke marr për bazë praktiken e mirë gjyqësore për këtë lloj të dëmit vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit më rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të paditurës përmes ankesës së paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimi të gabuar të së drejtës materiale që ka të bëjë më lartësinë e shumave të gjykuara paditësve në emër të dëmit jo material dhe material si dhe kamatës së gjykuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë sipas aktgjykimit të atakuar, ku me aprovimin e pjesshëm të pretendimeve të tyre ankimore, kjo gjykatë edhe ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar duke vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa për atë pjesë të pretendimeve ankimore të paditurës të cilat nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Apelit e Kosovës, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë më anë të këtij aktgjykimi.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 18.03.2020, e deri në pagesën definitive, sepse paditësit për dëmin dhe lartësinë e tij, kanë rënë në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tyre për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike - kontestimore, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e) e lidhur 201 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2268/2021, me datë 25.03.2024

Kryetari i kolegjit
Naim Mehulli